



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

ZYRA PËR REGJISTRIMIN, CERTIFIKIMIN DHE KONTROLLIN FINANCIAR TË SUBJEKTEVE POLITIKE (Zyra) NË KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ) sipas autorizimeve të dhëna me paragrafin 1 të nenit 21 të Ligjit Nr.08/L-122 për ndryshim plotësues të Ligjit Nr. 03/L-174 për Financimin e Subjekteve Politike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-058 dhe Ligjin Nr. 04/L-122, me datën 06.03.2025, merr këtë:

VENDIM

Për shqiptimin e gjobës për subjektin politik të regjistruar SHPRESA DEMOKRATE

- I. Subjektit politik SHPRESA DEMOKRATE, e regjistruar nga KQZ, me datën 06.10.2023, i shqiptohet gjobë në vlerë katër mijë (4,000) euro për shkak se, nuk ka dorëzuar raportin vjetor financiar për periudhën raportuese 2024.
- II. Vendimet e Zyrës për shqiptimin e gjobave janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme.
- III. Mjetet e mbledhura nga pagesat e gjobave transferohen në Buxhetin e Republikës së Kosovës.
- IV. Subjekti politik SHPRESA DEMOKRATE, obligohet që brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të këtij vendimi, të paguaj gjobën e shqiptuar në vlerën katër mijë (4,000) euro dhe të dorëzojë në Zyrë një kopje të fletëpagesës së gjobës së paguar.
- V. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Rregullores Nr. 06/2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike, subjekti politik SHPRESA DEMOKRATE, ka qenë i obliguar që më së voni me datën 01.03.2025, ta dorëzojë në Zyrë, raportin vjetor financiar për periudhën raportuese 01.01.2024 – 31.12.2024. Bazuar në nënparagrafin 4 të nenit 81 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, afati për dorëzimin e raportit vjetor financiar është shtyrë me datën 03.03.2025.

Zyra, para përfundimit të afatit për dorëzimin e raporteve vjetore financiare të periudhës raportuese 2024, ka dërguar njoftimet përmes e-mailit për obligimin ligjor për dorëzimin e raporteve vjetore financiare te personat e autorizuar të subjektit politik, me datën 25.02.2025.

Në bazë të nënparagrafit 6.5 të paragrafit 6 të nenit 21 të Ligjit Nr. 08/L-122 për Financimin e Subjekteve Politike, subjektit politik SHPRESA DEMOKRATE i shqiptohet gjobë në vlerë prej katërmijë (4,000) euro.

Subjekti politik SHPRESA DEMOKRATE, obligohet që pagesën ta kryejë brenda tridhjetë (30) pas pranimit të vendimit për shqiptimin e gjobës përmes komunikimit zyrtar elektronik. Pagesa e gjobës duhet të dëshmohet përmes dorëzimit të kopjes së fletëpagesës në Zyrë si dhe deri me datën 15 mars 2025 subjekti politik obligohet të dorëzoj në Zyrë raportin vjetor financiar për periudhën raportuese 2024.

Sipas paragrafit 17 dhe 18 të nenit 15 të Rregullores Nr. 06/2024 për Menaxhimin dhe Mbikëqyrjen Financiare të Subjekteve Politike, nëse subjekti politik, nuk e dorëzon raportin vjetor financiar, deri me datën 15 mars, Zyra i rekomandon KQZ që të marrë vendim për pezullimin e subjektit politik, ku e obligon subjektin politik që brenda afatit shtesë prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, ta dorëzoj në Zyrë, raportin vjetor financiar. Nëse subjekti politik nuk ndërmerret veprimet për dorëzimin e raportit vjetor financiar, brenda afatit shtesë të dhënë me vendimin për pezullim, sipas rekomandimit të Zyrës, KQZ merr vendim për çregjistrimin subjektin politik.

Nga sa u tha më lartë, Zyra vendosi për shqiptimin e gjobës në vlerë prej katër mijë (4,000) euro, sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Prishtinë, 06.03.2025

Drejtori i Zyrës

Besnik Buzhala

Vendimi i dërgohet:

- Kryetarit të subjektit politik SHPRESA DEMOKRATE.
- Përfaqësuesit të autorizuar financiar të subjektit politik SHPRESA DEMOKRATE.

Këshilla juridike: Subjekti politik mund të inicojë padi kundër vendimit të Zyrës për shqiptimin e gjobave, pranë gjykatës kompetente të shkallës së parë, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, pas njoftimit për vendimin. Inicimi i padisë nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.